



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT - Njoftim për medime -

Shkup, 25.03.2024


Masat dhe aktivitetet për përmirësimin e standardit studentor në fushën e funksionimit të konvikteve studentore janë të pamjaftueshëm efikase dhe ekonomike

Për realizimin e veprimtarisë standardi studentor, Ministria e Arsimit dhe Shkencës në vitin 2022 ka paguar 1,4 miliardë denarë e cila nuk është e mjaftueshme për të siguruar kushte adekuate për jetesë dhe ushqim të studentëve në konviktet studentore shtetërore

Enti Shtetëror i Revizionit ka kryer revizionin e suksesit me temë „Efikasiteti i masave, politikave dhe projekteve për përmbushjen e kushteve në të cilat funksionojnë konviktet shtetërore të studentëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe zhvillimi i standardit studentor” me qëllim që ti përgjigjet pyetjes „A ndërmerren masa dhe aktivitete institucionet kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut për përmirësimin e vazhdueshëm të standardit studentor”?

Në raportin e revizionit theksohet se, masat dhe aktivitetet për zhvillimin e standardit studentor që ndërmerren nga organet kompetente shtetërore **nuk janë mjaft efikase dhe ekonomike** për realizimin e një niveli të qëndrueshëm pavarësie financiare të konvikteve studentore, akomodim dhe ushqim adekuat, si dhe realizim të projekteve të rindërtimit dhe zgjerimit të kapaciteteve të konvikteve shtetërore të studentëve.

KSHP Shkup – KSHP Goce Delçev






Në fushën e bursave të studentëve janë vendosur disa masa të cilat janë adekuate, por ata nuk janë në pajtueshmëri me interesin për të studiuar sipas programeve të studimit, ndërsa për shkak të aplikimit të më shumë se një grup të bursave, parregullsive dhe dokumentacioneve të shumta gjatë përcaktimit të plotësisimit të kushteve, një pjesë e bursave nuk jepen. Gjithashtu, revizorët konstatuan se është vendosur mënyra e bursave për studime jashtë vendit me të cilat nuk siguron shfrytëzim efikas të mjeteve dhe përfitimeve të paguara për shtetin.

Revizorët konstatuan se verifikimin të cilën duhet ta bën MASH para fillimit me punë të konvikteve studentore, deri ditën e kryerjes së revizionit nuk është kryer për të gjithë konviktet shtetërore studentor dhe nuk kanë vendosur Regjistër i konvikteve studentore, që ndikon negativisht në zbatimin e procedurave për akomodimin e studentëve dhe realitetin e kapacitetit të shfaqur të konvikteve studentore.

Nuk është përgatitur një dokument i veçantë strategjik për standardin studentor me masa dhe aktivitete për zhvillimin dhe përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të studimit në vend.

Mjetet totale që janë realizuar në përputhje me Programin e Financimit, realizimin dhe zhvillimin e veprimtarisë standardi studentor për vitin 2022 janë në vlerë prej **1.397.455 mijë denarë (rreth 22,6 milionë euro)** dhe atë:




Mënyra e vendosur e **subvencionimit të ushqimit studentor** nga ana e MASH-it nëpërmjet pagesës në llogarinë e transaksioneve të studentëve nuk mundëson të vërtetohet se mjetet e paguara për vitin 2022 në shumë prej **701.482 mijë denarë (rreth 11,37 milion euro)** ose 50,2% nga mjetet totale për standardin studentor shfrytëzohen ekskluzivisht për qëllimin e përcaktuar me Ligjin për ushqimin e subvencionuar të studentëve, me çka gjatë vitit 2023 janë bërë ndryshime në Ligjin për ushqimin e studentëve në përpjekje për të zvogëluar mundësinë e kësaj sjelljeje të shfrytëzuesve të fondeve.

Për masat e **bursave të studentëve** revizorët vlerësuan se janë adekuate, por të njëjtit nuk janë në përputhje me interesat për studiime sipas programeve të studimit. Për një pjesë të programeve të studimit është paraparë shuma e bursave që është tri herë më e lartë nga shuma e rregullt që është përcaktuar në shumën e 6.050 denarë për të cilat ekziston mundësia për përmirësim nëpërmjet ristrukturimit të shpenzimeve të mbetura nga Programi.

Me masat për bursat për studentët pas konkursit për vitin 2022/23 janë paraparë **3105 bursa** prej të cilave janë **miratuar 2509 bursa**, ndërsa me bursa të përfshira të cilat janë miratuar paraprakisht, numri i **studentëve me bursë është 6179 studentë** në bazë të çlës MASH gjatë vitit 2022 ka paguar shumën prej **235,849 mijë denarë (rreth 3,8 milionë euro)**.

Rezultatet nga krahasimi i kryer i shumës së bursave të paguara për student në vendin tonë në krahasim me vendet fqinje e paraqesim në tabelën si vijon:



Revizorët konstatuan rënie të evidentuar të numrit të bursave të miratuara në periudhën 2019-2022, por edhe rritje të numrit të aplikimeve si dhe numrit të studentëve të refuzuar, e cila për vitin 2022/23 arriti në 2,942 gjë që tregon për një interesim të madh të studentëve, por edhe dobësi në procedurën e dhënies së bursave sidomos në pjesën e sigurimit të dokumentacionit të nevojshëm.

Numri i studentëve që aplikuan për bursa dhe të cilëve është aprovuar e njëjta është paraqitur në tabelën si vijon:

	2019/2020	2020/2021	2021/2022	2022/2023
Bursat të publikuar sipas konkursit	3.075	3.075	3.075	3.105
Studentët e aplikuar sipas konkursit	4.480	4.331	4.704	5.451
Bursat e aprovuar	2.697	3.026	2.797	2.509
Bursat të paaprovuar	1.783	1.305	1.907	2.942

Revizorët konstatuan se **për studim në një nga 100 universitetet e para në botë** në vitin 2022 për **111 studentë**, janë paguar mjete në vlerë prej **188,361 mijë denarë (rreth 3 milionë euro)**, të cilat kanë pjesëmarrje prej 44,4% në totalin e mjeteve për bursa. Në të njëjtën kohë, shuma maksimale e paguar nga MASH për një student është deri në 40.000 dollarë dhe për qëndrim mujor prej rreth 45 mijë denarë për gjithsej 10 muaj gjatë vitit. Një numër i madh i studentëve me bursa nuk i respektojnë kushtet kontraktuale dhe nuk kthehen në vend pas përfundimit të studimeve, dhe për këtë arsye fondet nuk shfrytëzohen në mënyrë efikase.


Në raportin e revizionit janë shënuar edhe kushtet që lidhen me akomodimin dhe ushqimin e studentëve dhe funksionimin e KSHS-ve, të cilat i referohen:

- një ulje e ndjeshme e kapaciteteve akomoduese të të gjitha konvikteve shtetërore të studentëve në periudhën 2019 – 2022, gjegjësisht nga 5,815 shtretër në 4,490 në 2022, që paraqet 77,28% të zënë, por edhe devijime në numrin e studentëve të akomoduar në krahasim me konkursin e paraparë;
- pagesa e fondeve për konviktet shtetërore të studentëve nuk bëhet në bazë të listave të përditësuara të studentëve të akomoduar që miratohen nga personi përgjegjës në MASH.
- objektet që përdor KSHS janë kryesisht të vjetra dhe nuk plotësojnë nevojat e jetesës bashkëkohore;

- kushtet e pabarabarta të cilat i ofrojnë konviktet studentor dhe interesi i studentëve për akomodim në KSHS të caktuara dhe
- pakënaqësia e studentëve në lidhje me ushqimin, akomodimin dhe funksionimin e konvikteve studentore.

Nga ana e ekspertit të pavarur të angazhuar është kryer analizë e çmimit përkatës të caktuar për akomodim i cili është burim bazë e të ardhurave të KSHS dhe është përcaktuar se e njëjta nuk është ndryshuar nga viti 2008 dhe është 6.820 denarë në muaj, për 10 muaj në vit nga e cila MASH merr pjesë me 50% nga çmimi, dhe pjesën tjetër e paguajnë studentët. E njëjta nuk siguron nivel të kënaqësisë së mirëmbajtjes financiare të konvikteve që të tregojnë për nevojën e një përcaktimi real të çmimit ekonomik për akomodimin dhe ushqimin për studentët në KSHS.


Pjesëmarrja e mjeteve nga Programi i standardit studentor të dedikuara për funksionimin e konvikteve studentor është paraqitur në grafikonin si vijon:



Revizioni në bashkëpunim me ekspert të pavarur të angazhuar zbatoi dhe anketë për kënaqësinë e studentëve nga kushtet në konviktet studentore. Rezultatet e anketës, në të cilën pyetjeve të parashtruara iu përgjigjën 286 student (me nota nga 1 deri në 5), pra rreth 8,25% e numrit të përgjithshëm, janë paraqitur në tabelën si vijon:

Sa jeni të kënaqur me kushtet e mëposhtme në konviktin ku po qëndroni?	Nota mesatare
Ushqimi (cilësia, shumëllojshmëria, sasia)	2.64
Higjiena (sanitare, pastërtia, disponueshmëria e ujit të nxehtë)	2.41
Mobileri (gjendja fizike, funksionaliteti)	3.33
Dhomat e banimit (pamjet katrore, pajisjet, kushtet e tjera fizike)	2.98
Pajisjet teknike (printer, fotokopjues, kompjuter, TV)	1.67
Internet (stabiliteti, shpejtësia, fuqia e sinjalit)	1.81
Kushtet/atmosfera e mësimit (izolimi i zërit, respektimi i rregullave të shtëpisë, hapësira e përshtatshme)	2.53
Hapësirat e përbashkëta (mensa, salla e leximit/biblioteka, sipërfaqja e oborri)	3.07
Kushtet sportive dhe rekreative (rekuizita dhe hapësira për sport dhe rekreacion)	2.12
Aktivitete kulturo-argëtuese në konviktin e studentëve	2.46
Ngrohja dhe ftohja e hapësirës	2.58
Siguria e objekteve dhe studentëve	2.80

Në bazë të të dhënave të marra nga konviktet shtetërore të studentëve është kryer edhe analiza e sasisë së produkteve ushqimore bazë që janë më të zakonshme në ushqimin e studentëve në konviktet individuale studentore. Rezultatet e kësaj analize janë paraqitur në grafikonin si vijon:



Në pjesën e investimeve, revizorët theksojnë se Projekti i efikasitetit të energjisë me të cilën planifikohet rikonstrukcion të thellë i të gjitha konvikteve shtetërore të studentëve në vend është filluar nga ana e MASH. Njëkohësisht, për këtë projekt është siguruar kredi dhe grant në vlerë të përgjithshme prej 24.785.067 euro, megjithatë, ka paqartësi në lidhje me mjaftueshmërinë e fondeve të parashikuara për zbatimin e plotë të këtij projekti në pajtim me të planifikuarën, dhe aktivitetet për rindërtimin e banesave nuk kanë filluar ende.

Në lidhje me zgjerimin e kapaciteteve të KSHS gjatë revizionit, ka përfundura ndërtimi i KSHS Tetovë me kapacitet për 300 student, por ende nuk është bërë procesverbali për pranimin teknik dhe nuk ka përfunduar plotësisht procedura për vënien në përdorim të këtij objekti në mënyrën e përcaktuar në rregulloret ligjore të kësaj fushe.

Прес контакт:

Албиона Мустафа Мухацири +389 72228 203 albiona.mustafa@dzr.gov.mk

Мијалче Дургутов +389 70 358 486 mijalce.durgutov@dzr.gov.mk

Мартин Дувњак +389 75 268 517 martin.duvnjak@dzr.gov.mk